



rB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 2852 prot

Vlorë, më 20.02.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ datë ____ 2025

PËR

“MIRATIMIN E NGRITJES SË QENDRËS DITORE PËR TË MOSHUARIT.”

Në mbështetje të Ligjit nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit 139/2015 "Për Vetqeverisjen vendore"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018 Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.823 datë 06.12.2006 për "Standartet e shërbimeve për të moshuarit në qendrat ditore".
" Njoftim për mbështetje dhe financim në kuadër të Fondit Social 2025 për ofrimin e shërbimeve për të moshuarit në qendër ditore", hyrë në Bashkinë Vlorë me nr. 1952 prot, datë 06.02.2025; , Ligji nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 45, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 44 ; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018, Marreveshje bashkëpunimi nr.381prot, datë 13.01.2025 ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Vlorë për zbatimin e projektit "Qender ditore për të moshuarit", V.K.B nr.111 datë 27.12.2024 "Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2025".VKB nr.101 date 27.11.2024 "Për Miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara për vitin 2025",VKB nr 102 datë 18.12.2024 "Për krijimin e ndërmarrjeve dhe miratimin e numrit të punonjësve për vitin 2025".

V E N D O S I

1. Miratimin e ngritjes së Qendrës Ditore të të Moshuarve në përmbushje të një prej objektivave të vendosur në Planin Social Vendor 2025-2027 .
2. Akordimin e Fondit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kuadër të Planit Social, në një vlerë prej 4.413.247 Lek ku përfshihen paga dhe ushqimi e Fondit të Bashkisë Vlorë në një vlerë prej 440,000 lekë ku përfshihen vlera e energjisë elektrike, ujit dhe mirëmbajtjes së godinës.

3. Miratimin e ngritjes së strukturës për ofrimin e shërbimeve për të moshuarit në qendër ditore përbërë prej 4 pozicioneve si më poshtë:

Nr.	Pozicioni i punës	KLASA	POZICIONI
1	Kordinator Shërbimesh	IV-3	70,000
2	Psikolog	IV-4	60,000
3	Punonjës social	IV-4	60,000
4	Kuzhinierë		42,800

4. Numri i personelit 4 (katër) punonjës.
5. Fondi i pagave është në shumën 2,666,844 lekë.
6. Fondi i sigurimeve shoqërore është në shumën 445,363 lekë.
7. Fondi i shpenzimeve operative (shpenzime për ushqim) është në shumën 1,301,040 lekë.
Totali (pika 5+6+7) është në shumën 4,413,247 lekë.
8. Fondi i pagave për punonjësit e qendrës ditore të të moshuarve është i bazuar në fondet e disbursuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
9. Kontributi i Bashkisë Vlorë është në masën 10% të fondit në shumën 440,000 lekë për shpenzime operative (ujë, energji, detergjent, mirëmbajtje godine).
10. Shuma prej 440,000 lekë do të përballohet nga fondet e Bashkisë të miratuara me VKB nr.111 datë 27.12.2024 në programin 1110, grupi 5, artikulli 602.
11. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë;
12. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

PËR

“MIRATIMIN E NGRITJES SË QENDRËS DITORE PËR TË MOSHUARIT.”

Bashkia Vlorë në kuadër të nevojës për të zgjeruar shërbimet me bazë komunitare dhe ato psiko sociale ka vlerësuar domosdoshmërinë e ngritjes së një Qendre Ditore për të Moshuarit. Ngritja e një qendre ditore për moshën e tretë është një ndër objektivat e planit social të Bashkisë Vlorë 2025- 2027, të dala si pjesë e procesit të vlerësimit dhe konsultimit me grupet e interesit. Nga ky proces është identifikuar që për të moshuarit është e domosdoshme që të përmirësohen shërbimet, duke ngritur shërbime të reja për trajtimin e problemeve që lidhen kryesisht me të moshuarit që jetojnë vetëm dhe jo vetëm. Nga zbatimi i këtij projekti, përmbushet një nga prioritetet e parashikuara në planin e veprimit 2025-2027 për zhvillimin e shërbimeve ekzistuese dhe atyre të reja. Shërbimet që do të ofrohen nga projekti, ndihmojnë në zgjidhjen e problematikave që përballen të moshuarit për të aksesuar shërbime komunitare dhe sipas nevojave të tyre, ndaj lidhen drejtpërsëdrejti dhe me objektivat e Programit të Fondit Social nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bazë të VKM Nr 150/ 2019 .

Bashkia Vlorë aplikoi për ngritjen e këtyre shërbimeve pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Social nëpërmjet mekanizmit të Fondit Social. Ministria e përzgjedhi projektin si fitues dhe ka njoftuar Bashkinë me shkresë zyrtare Nr. 629/8 datë 04.02.2025 dhe hyrë në bashki me shkresën nr.1952 prot., datë 06.02.2025.

Ngritja e Qendrës Ditore për të Moshuarit, synon të zgjerojë gamën e shërbimeve me bazë komunitare nëpërmjet objektivave specifike dhe të matshëm:

Objektivi 1.: Përshtatja e ambjentit të parashikuar për Qendrën Ditore për të Moshuarit në nevojë dhe jo vetëm në ambjentet e Rajonin Nr.4.

Shënim : Për vitin e parë të projektit, shërbimet do të ofrohen në ambientet te Gjendja Civile, kati i dytë, ish-qendra ditore për të moshuarit.

Objektivi 2.: Ngritja e strukturës me staf psikosocial për ofrimin e shërbimeve.

Objektivi 2.1: Organizimi i Shërbimeve: Krijimi i një sistemi të strukturuar shërbimesh që përfshin aktivitete, vakt ushqimor dhe mbështetje shëndetësore për të siguruar një funksionim efikas.

Objektivi 2.2 Trajnimi i Stafit: trajnime të rregullta në fushat e kujdesit ndaj të moshuarve, komunikimit dhe menaxhimit të krizave.

Objektivi 3 Funksionimi i Qendrës Ditore

Objektivi 3.1 Mbështetje Sociale: Krijimi i një ambienti miqësor që inkurajon ndërveprimin social dhe ndihmon në zvogëlimin e ndjenjës së izolimit.

Objektivi 3.2 Mbështetje Psikologjike: Ofrimi i ndihmës psikologjike dhe këshillim për të përballuar stresin dhe sfidat emocionale që shoqërojnë pleqërinë.

Objektivi 3.3 Shëndeti dhe Mirëqenia: Ofrimi i shërbime për kontrollin e shëndetit, si matja e tensionit të gjakut, konsultime mjekësore, dhe informacione mbi ushqimin e shëndetshëm.

Objektivi 3.4 Aktivitetet Krijuese: Krijimi i ambienteve dhe mundësive për aktivitete krijuese, si piktura, artizanat, dhe muzikë, për të stimuluar kreativitetin dhe përmirësuar ndjenjën e mirëqenies

Objektivi 4 Qëndrueshmëria në kohë e Qendrës Ditore

Objektivi 4.1 Planifikimi i Aktiviteteve: Hartimi i një kalendari aktiviteteve që përfshin takime, vizita, dhe aktivitete festive për të mbajtur angazhimin e të moshuarve.

Objektivi 4.2 Inkurajimi i Vullnetarizmit: Pas identifikimit dhe trajnimit të grupit të rinjëve volitet që ndërveprimi mes tyre dhe moshuarve të inkurajohet dhe mbështetet për të kontribuar në komunitet, duke rritur ndjenjën e qëllimit dhe ndihmës.

Objektivi 4.3 Krijimi i Partneriteteve: Zhvillimi i marrëdhënie të bashkëpunimit me organizata të tjera për të ofruar më shumë burime dhe shërbime për të moshuarit dhe aplikimi në projekte me fokus këtë target grup.

Objektivi 4.4 Trajnimi i Stafit: Parashikimi i Trajnimeve të rregullta në fushat e kujdesit ndaj të moshuarve, komunikimit dhe menaxhimit të krizave.

Objektivi 4.5 Promovimi i Aktivitetit Social: Të gjitha aktivitetet e parashikuara do të promovohen që të inkurajojnë socializimin dhe ndërveprimin edhe mes të moshuarve të tjerë për të mbajtur një atmosferë pozitive në qytet.

Numri i të moshuarve si përfitues :

- Rreth 100 të moshuar përfitues të shërbimeve të ofruara ne qendër.
- 30 të moshuar në nevojë- vakt ditor ushqimor.
- 25 të moshuar të braktisur , 45 të moshuar me aftësi të kufizuara- përfitues të shërbimeve psiko sociale dhe shëndetësore parësore pranë banesës .

Funksionimi i qendrës ditore do të bazohet në një rregullore të mirëpërcaktuar e cila do të ketë personat përgjegjës për cdo angazhim. Aktivitet ditor i qendrës do të jetë këshillimi, mbështetja sociale, kujdesi parësor shëndetësor, një vakt ushqimor dhe ambjentet në dispozicion të të moshuarve. Shërbimi i ri do të jetë në varësi dhe menaxhohet nga Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social.

Shërbimi do të ketë 4 punonjës: një koordinator shërbimi, një punonjës socialë, një psikolog, një kuzhinierë, një sanitare.

Baza Ligjore:

- Ligjin nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë",
- Ligji 139/2015 "Për Vetqeverisjen vendore, funksionimin, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe të organeve përkatëse";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 20.3.2019 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror";
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.823 datë 06.12.2006 për "Standartet e shërbimeve për të moshuarit në qendrat ditore".
- Udhëzimi 581 datë 18.12.2017 për "Standartet për shërbimin në familje për të moshuarit".

Drejtoresha e Ndhmës dhe Shërbimit Social

Irena STASA